



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 38/ Prot.

Tiranë, më 11.02.2020

**PROCESVERBAL**

Sot, më datën 11.02.2020 ditë e hënë, ora 11.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u mbajt mbledhja plenare e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mbledhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahimimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Arben Dollapaj
6. Bujar Sheshi
7. Kosta Beluri
8. Sandër Beci
9. Esmeralda Keshi
10. Vate Staka

Nuk është i pranishëm anëtari:

1. Besnik Cani

Nga administrata e KLP janë të pranishëm:

1. Drejtori i Kabinetit

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë z.Gent Ibrahimimi, i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të



Drejtësisë” i ndryshuar, pasi verifikon pjesëmarrjen e anëtarëve dhe kuorumin, bën hapjen e saj dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:

### **Rendi i Ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datës 27.01.2020 dhe 31.01.2020 të Këshillit.
2. Miratimi i projektakteve për emërimin dhe caktimin në detyrë të 10 (dhjetë) magistratëve të rinj të diplomuar në vitin 2019 në Shkollën e Magjistraturës.
3. Miratimi i projektaktit për dhënie leje të papaguar bazuar në kërkesën e prokurorit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.
4. Miratimi i projektaktit “Për krijimin e seksioneve për të miturit pranë prokurorive”.
5. Miratimi i raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Ervin Karanxha.
6. Miratimi i raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Artan Hasbi.
7. Miratimi i projektaktit “Për miratimin e aktiviteteve trajnuese të shkollës së magjistraturës për periudhën janar-mars 2020.
8. Miratimi i projektaktit për pranimin e dorëheqjes së prokurorit Erion Pustina, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.
9. Miratimi i Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.
10. Të tjera (Paraqitja e raporteve vjetore nga Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë të Prokurorisë).

**Z. Ibrahim** pyet nëse anëtarët kanë çështje të tjera për ti përfshirë në rend të ditës.

**Z. Staka** propozon që të hiqet nga rendi i ditës pika 9 për mbledhjen e ardhshme. Argumenton që kjo pikë ka nevojë për një shqyrtim më të hollësishëm.

**Z. Bazaj** shprehet që duhet të njihen më mirë me aktet.

**Z. Ibrahim** ndan të njëjtin mendim me anëtarët e sipërcituar.

**Z. Balla** shprehet se, Këshilli duhet të tregohet më racional, propozon që kjo pikë të trajtohet sot dhe nëse shihet e arsyeshme Këshilli mund ta tërheqë, por jo paraprakisht ta heqim nga rendin i ditës.

**Znj. Seiti** mendon se kjo është një çështje komplekse, por pa përjashtuar mundësinë që, anëtarët mund të bien dakord.

**Z. Ibrahim** hedh në votim propozimin e z. Staka.

**Miratohet me 8 vota pro. Kundër znj. Seiti dhe z. Balla.**



**Z. Ibrahim** propozon që të përfshihet në rend të ditës kërkesa e Shkollës së Magjistraturës, e cila nëpërmjet një shkrese bën më dije për një pozicion vakant, për pedagog të brendshëm për një periudhë 5 vjeçare.

**Z. Ibrahim** hedh në votim propozimin për përfshirjen në rendit e ditës të çështjes më lart.

**Miratohet unanimitisht.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datës 27.01.2020, 31.01.2020, 05.02.2020 të Këshillit.*

**Miratohet unanimitisht.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.


- *Miratimin e projekt akteve për emërimin dhe caktimin në detyrë të 10 (dhjetë) magistratëve të rinj të diplomuar në vitin 2019 në Shkollën e Magjistraturës.*

**Z. Ibrahim** i kalon fjalën z. Beci të relatoj.

**Z. Beci** relaton në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi procedurën e ndjekur për caktimin e këtyre magistratëve të rinj pranë prokurorive përkatëse. Ky komision ka bërë propozimet përkatëse, projektvendimet dhe relacionet për çdo magistrat, referuar dhe pozicioneve përkatëse. Gjithashtu, Komisioni, në mbledhjen e zhvilluar me këta magistratë, ka patur parasysh të përputhte aq sa ishte e mundur, bazën ligjore si dhe kërkesave të tyre. Në këtë mbledhje, magistratët e rinj, patën mundësi të bënin një prezantim të tyre dhe shfaqën mirëkuptim dhe një vullnet të mirë, lidhur me emërimin e tyre në vendet vakante. Komisioni i propozon Këshillit, mbështetur në nenin 55, pika 1, gërma c, nenin 39, pika 3, i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, pika 1, nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 166 dhe 189/1/a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, nenin 39, pika 3, në nenin 35 dhe 39 të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ta miratojë këtë listë.

**Z. Ibrahim** hedh në votim miratimin e listës së projekt akteve si më poshtë:

Z. Adnan Hoxha, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër



Z. Florian Boriçi, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë

Z. Gëzim Spahiu, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër

Z. Ledion Tema, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat,

Z. Gjergj Ceka, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë

Znj. Ermira Manelli, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë

Z. Pierind Çukaj, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë

Znj. Aurora Hajro, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë,

Znj. Alba Dhima, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë

Znj. Xhoana Mehmetaj, caktohet në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.

**Z. Ibrahim** lexon vendimet e Këshillit dhe kërkon të njoftohen me to magjistratët e mësipërm, Prokurori i Përgjithshëm, dhe prokuroritë përkatëse. Këto vendime hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në faqen zyrtare të Këshillit.

Në votimin e z. Florian Boriçi, z. Adnan Hoxha, znj. Ermira Manelli, z. Gjergj Ceka, z. Ledion Tema, mungon z. Bazaj.

### **Miratohen unanimit**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projekt aktit për dhënie leje të papaguar bazuar në kërkesën e prokurorit{....}, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.*

**Z. Ibrahim** i kalon fjalën z. Balla të relatojë.



**Z. Balla** relatton në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Komisioni vlerëson se, kërkesa për dhënie leje të papaguar, për një periudhë 2 mujore (01.03.2020-30.04.2020), bazuar në kërkesën e prokurorit {...}, nuk bie ndesh me ushtrimin e funksionit të tij dhe drejtuesi i prokurorisë përkatëse ka dhënë pëlqimin e tij.

**Z. Ibrahim** pyet nëse ka pyetje dhe komente.

**Znj. Seiti** ngre shqetësimin për mënyrën se si Këshilli do t'i zgjidhë këto probleme që krijohen nga këto vakanca.

**Z. Bazaj** propozon që, Këshilli të zbatojë procedurën e komandimit për Prokurorinë e Përmetit, edhe pse kjo prokurori nuk ka aq ngarkesë sa ajo e Sarandës.

**Z. Ibrahim** hedh në votim miratimin e projektvendimit.

**Miratohet unanimitisht.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e katërt të rendit të ditës.

- *Miratimin e projekt aktit “Për krijimin e seksioneve për të miturit pranë prokurorisë”.*

Z. Ibrahim relatton vendimin e Këshillit për të caktuar 3 prokurorë në seksionin për të miturit, pranë prokurorisë. Citon bazën ligjore: neni 21, pika 1, 2 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, dhe Kodit Civil dhe atij penal për të rritur.

**Z. Ibrahim** pyet nëse ka pyetje dhe komente.

**Rreth kësaj çështje u diskutua:**

**Z. Beluri** sqaron se në vendim duhet të shprehen vetëm parashikimet ligjore. Shtron pyetjen, nëse është kompetencë e KLP të dalë me një vendim. Dhe z. Dollapaj i bashkohet këtij mendimi, me argumentin që, nuk është kompetencë e Këshillit por e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili në koordinim me drejtuesit e prokurorisë, bën organizimin e punës. Propozon që, Këshilli ta tërheqë këtë akt për ta shqyrtuar më hollësisht.

**Z. Bazaj** shprehet se, në prokuroritë e rretheve të vogla, nëse 3 prokurorë do të ishin të angazhuar në një ditë, atëherë duhet të ketë 3 specializime. Krijohet një ngërç dhe ngre shqetësimin se si do të zgjidhet ky problem?

**Z. Sheshi** i bashkohet mendimit të dy kolegëve. Argumenton se, në ligjin për prokurorinë parashikohen qartë kompetencat përkatëse për seksionet e posaçme. Nuk është kompetencë e Këshillit, kjo i tejkalon detyrat e tij, është kompetencë e drejtuesit të prokurorisë.



**Znj. Keshi** u shpreh se, ligji për prokurorinë shprehet qartë se, ndryshe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, KLP nuk e ka këtë kompetencë krijimin e këtyre seksioneve, por vetëm specializimin e prokurorëve.

**Z. Ibrahim** ndan të njëjtin mendim me mendimet e anëtarëve parafolës, duke argumentuar që nuk është në kompetencë dhe në përgjegjësinë e Këshillit.

**Z. Ibrahim** hedh në votim kërkesën për tërheqjen e këtij akti.

**Miratohet unanimitisht.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e pestë të rendit të ditës.

- *Miratimin e raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Ervin Karanxha.*

**Z. Ibrahim** i kalon fjalën z. Beluri.

**Z. Beluri** relatton në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale. Komisioni pasi ka bërë verifikimet përkatëse, vlerëson që subjekti i plotëson të gjitha kriteret ligjore. Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit ta miratojë këtë raport.

**Z. Ibrahim** hedh në votim miratimin e raportit.

**Miratohet unanimitisht.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e gjashtë të rendit të ditës.

- *Miratimin e raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi.*

**Z. Ibrahim** i kalon fjalën z. Beluri.

**Z. Beluri** relatton në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale. Komisioni pasi ka bërë verifikimet përkatëse, vlerëson që subjekti i plotëson të gjitha kriteret ligjore. Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit ta miratojë këtë raport.

**Z. Ibrahim** hedh në votim miratimin e raportit.

**Miratohet unanimitisht.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e shtatë të rendit të ditës.



- *Miratimin e projekt aktit “Për miratimin e aktiviteteve trajnuese të shkollës së magjistraturës për periudhën janar-mars 2020.*

**Z. Ibrahim** i kalon fjalën z. Balla.

**Z. Balla** relatton kërkesën e ardhur nga Shkolla e Magjistraturës mbi miratimin e aktiviteteve trajnuese të shkollës së magjistraturës për periudhën janar-mars 2020. I referohet nenit 186, 272, pika 3 e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i propozon Këshillit ta miratojë projekt aktin.

**Z. Ibrahim** pyet nëse ka pyetje dhe komente.

**Rreth kësaj çështje u diskutua:**

**Z. Beluri** i propozon Këshillit që të krijohet një bazë të dhënash për sa i përket aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës.

**Z. Ibrahim** bën me dije se, sektori i Burimeve Njerëzore e ka marrë përsipër këtë detyrë.

**Z. Ibrahim** hedh në votim miratimin e raportit.

**Miratohet unanimisht.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e tetë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektit për pranimin e dorëheqjes së prokurorit Erion Pustina, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.*

**Z. Ibrahim** i kalon fjalën z. Beluri.

**Z. Beluri** relatton në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale. Komisioni pasi shqyrtoi kërkesën, e mbështetur në nenin 65, pika 2, të ligjit nr.95/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, në nenet 64,65, të këtij ligji, si dhe në nenin 186, pika 2 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i propozon Këshillit ta miratojë këtë kërkesë dhe të deklarojë me vendim mbarimin e statusit për këtë prokuror. Prokurori nuk ka parashtruar arsyet e dorëheqjes.

**Z. Ibrahim** hedh në votim miratimin e projektaktit.

**Miratohet unanimisht.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën që u përfshi në rend të ditës.

Z. Ibrahimimi e bën me dije Këshillin, për kërkesën e ardhur nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, ku i kërkon Këshillit të nisë procedurat për komandimin e një magjistrati nga radhët e prokurorëve. Z. Ibrahimimi thekson se, situata në sistemin e prokurorisë, për shkak të vakancave është e vështirë dhe emergjente dhe në këto kushte emërimi qoftë dhe i një prokurori jashtë këtij sistemi, do ta vështirësonte dhe më shumë situatën. Mirëkupton kërkesën e Shkollës së Magjistraturës me argumentin që kërkesa e bërë prej saj, ka baza të forta, nisur nga nevoja.

**Z. Ibrahimimi** pyet nëse ka pyetje dhe komente.

**Rreth kësaj çështje u diskutua:**

**Znj. Seiti** mendon që, në këtë pozicion, mund të emërohet dhe një pedagog që nuk vjen nga radhët e prokurorisë. Argumenton që, studentët e kësaj shkolle, bëjnë praktikë në vitin e tretë të viti akademik, në këto kushte e konsideron absurde që të emërohet një pedagog (prokuror) për një periudhë 5 vjeçare. Vlerëson si element thelbësor kohëzgjatjen.

**Z. Dollapaj** shprehet se, kërkesa që parashtron Shkolla e Magjistraturës është e drejtë, madje e vlerëson këtë kërkesë. Argumenton që, ky pedagog të jetë nga radhët e prokurorëve sepse me përvojën që ai ka do të ndikojë më së miri në formimin e këtyre magjistratëve. I propozon Këshillit ta miratojë.

**Z. Beci** vlerëson që, është dakord që të ketë pedagog nga radhët e prokurorisë, me argumentin që, këta prokurorë me përvojën e tyre do të japin një kontribut të madh pranë Shkollës së Magjistraturës, Këshilli nuk duhet t'i kufizojë.

**Z. Bazaj dhe z. Sheshi**, mbështesin këtë propozim, me argumentin që, një prokuror me përvojën e tij do të jepte një kontribut të madh dhe efektet e dëshiruara në të ardhmen.

Edhe **znj. Keshi** është dakord për këtë propozim, me argumentin që është një gjë shumë pozitive. Ashtu si z. Sheshi, vlerëson që, 1 vit akademik (variant i dalë nga diskutimet në Këshill), është i pamjaftueshëm, për të qenë produktiv duhet 3 vjet.

**Z. Beluri** nuk është dakord për emërimin e një prokurori, me argumentin që, numri i prokurorëve në juridiksionin e përgjithshëm po ulet dhe një emërim i tillë do të pakësonte numrin e prokurorëve në sistem. Megjithatë, në kuadër të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, e cila ka qenë e detyruar nga vështirësitë që ka hasur, i propozon Këshillit ta miratojë. Propozon që, afati të jetë 3 vjet.

**Z. Ibrahimimi** nuk është dakord por mbështet arsyetimin e z. Sheshi dhe z. Dollapaj, sepse ndërthurja e teorisë me praktikën, do të jepte një rezultat më të kënaqshëm. Nuk është dakord dhe për afatin kohor (5 vjet), me argumentin se është një kohë e gjatë dhe nuk i shërben nevojave aktuale të sistemit.



Edhe z. Balla ndan të njëjtin mendim si z. Ibrahimimi. E vlerëson të panevojshme këtë emërimin, me argumentin që, kjo do të pakësonte numrin e prokurorëve në sistem dhe se Shkolla e Magjistraturës ka në përbërje të saj, ish-prokurorë me përvojë dhe të specializuar. Shprehet se, një prokuror i duhet më tepër sistemit sesa shkollës.

**Z. Ibrahimimi** hedh në votim miratimin e projekt aktit.

**Miratohet me 8 vota pro. Kundër: z. Balla dhe z. Ibrahimimi.**

**Z. Ibrahimimi** hedh në votim miratimin për një afat 3 vjeçar.

**Miratohet me 5 vota pro. Kundër: Znj. Seiti z. Beci, z. Balla, z. Ibrahimimi.**

**Z. Ibrahimimi** lexon vendimin mbështetur në nenin 53,54, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe në nenin 176/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

**Z. Ibrahimimi** hedh në votim

**Miratohet me 9 vota pro. Mungon z. Staka.**

**Z. Ibrahimimi** vijon me pikën e fundit të rendit të ditës

- *Paraqitjen e raporteve vjetore nga Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*

**Z. Ibrahimimi** bën me dije se, të gjitha raportet vjetore nga Komisionet e përhershme janë dorëzuar në kohë.

**Z. Ibrahimimi** pyet nëse ka pyetje dhe komente.

**Z. Balla** përgëzon anëtarët për punën e bërë dhe në veçanti Komisionin e Zhvillimit të Karrierës dhe atë të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

**Z. Sheshi** kërkon fjalën dhe në emër të Komisionit të Disiplinës, i propozon Këshillit hartimin e një Rregulloreje për këtë Komision në kuadër të Rregullores së Përgjithshme të KLP, si dhe hartimin e një Regjistri për ecurinë mbi masat disiplinore.


**Z. Beci** i kujton Këshillit që është duke përfunduar afati i aplikimit për dy vendet vakante për në SPAK.

SEKRETA

Në përfundim duke mos patur pika të tjera për diskutim Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

### Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)



### Shënim:

(Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit)

Lidhur me këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. — Datë — 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. — datë — (Bashkëngjitur kopjet e dokumenteve) Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë 24/02/2020 Procesverbali të arkivohet.

**PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE**

**Frederik Sulisufi**

